

## Ftesë për Shprehje Interesi

### PËR SHËRBIMIN E DISTRIBUCIONIT ONLINE TË KANALEVE TË RTK-së

Radio Televizioni i Kosovës duke u bazuar në Ligjin për RTK –në, publikon shpalljen për shprehjen e interesit për distribucionin online të kanaleve të RTK-së.

Kompanitë të cilat janë të interesuara të ofrojnë zgjidhje teknike dhe financiare duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

- Të posedojë kapacitete teknike për distribuim të aseteve digjitale të RTK-së si RTK 1, 2, 3, 4 si dhe Radio Kosova 1 dhe 2 (stream 24/7);
- Të posedojnë kapacitete teknike për të kufizuar distribuimin e kanaleve të RTK-së përmes filtrave gjeografik sipas kërkesave të RTK-së.
- Të posedojnë platformë për monetizimin e shikueshmërisë.
- Të përshkruajnë në detaje ofertën/kapacitetet e tyre teknike;
- Të përshkruajnë në detaje ofertën e tyre financiare;
- Të sjellin 3 referenca për punën të ngjashme gjatë tri viteve të fundit;
- Të dorëzojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve;
- Të dorëzojnë certifikatën e numrit fiskal;
- Të sjellin vërtetim nga administrata tatimore e Kosovës (ATK) se i kanë kryer obligimet tatimore;
- Të kenë qarkullim financiar së paku 150,000 euro në tri vitet (kombinuar);

RTK ka të drejtë të kërkojë edhe sqarime dhe dokumentacion shtesë nga kompanitë ofertuese nëse është e nevojshme, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë.

Kërkesa për shprehjen e interesit, duhet të dorëzohet në kuvertë të mbyllur, duke filluar nga 25.11.2022 deri më 02.12.2022 në ora 16:00, në zyrën e Administratës nr 77 në ndërtesën e Radiotelevizionit të Kosovës, në adresën: Rr: “Xhemajl Prishtina” Nr 12 Prishtinë.

Për çdo informatë mund të kontaktoni përmes adresës elektronike : [youtube@rtklive.com](mailto:youtube@rtklive.com)